




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opstine/Mayor's Office

Nr.02/02

Datë:05/01/2024

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, me qëllim të vlerësimit të poezive sipas konkursit letrar me nr. 09/121 të datës 04.12.2023, për nder të 15 janarit - 25-vjetorit të Masakrës së Reçakut, si dhe sipas nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari merr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i pavarur dhe profesional për vlerësimin e poezive të "Orës së madhe letrare" të datës 14.01.2024 në nder të 25-vjetorit të Masakrës së Reçakut të datës 15.01.2024.
2. Anëtarët e Komisionit sipas pikës i të dispozitivit caktohen:
 - 1.Prof. Dr. Shyqri Galica – kryetar i Komisionit,
 - 2.Prof. Zyrafete Shala – anëtare e Komisionit,
 - 3.Prof. Asoc. Dr. Merxhan Avdyli – anetar i Komisionit.
3. Anëtarët e Komisionit i kryejnë detyrat e tyre me përgjegjësi dhe objektivitet duke qenë tërësisht të pandikuar dhe profesional në angazhimin e tyre.
4. Anëtarët e Komisionit e kanë të drejtën e kompensimit monetar në vlerë 200 euro për secilin.
5. Mandati i Komisionit është i vlefshëm deri në përmbylljen e aktivitetit sipas qëllimit të themelimit.
6. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Iu dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Shtimes
Arkivit.

Kryetari i Komunes
z. Qemajl Aliu

